



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PATOS  
KOMISIONI I VLERËSIMIT

Nr. 3096/11 Prot

Patos më 24/12 /2018

**SHPALLJE**  
**PËR LICENCIMIN E LINJËS NDËRQYTETASE USHQYESE**  
**PATOS – FIER - PATOS**

Në mbështetj të ligjit nr.8308 dt.18.03.1998 “Për Transportin Rrugor” i ndryshuar, Udhëzimit nr.5627 dt.18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” i ndryshuar, Bashkia Patos shpall konkurimin për licencimin e linjës ndërqytetase ushqyese Patos – Fier – Patos.

Aplikuesi duhet të paraqesi pranë Bashkisë Patos dokumentacionin e mëposhtme, brënda dates 11.01.2019;

1. Vetëdeklarimi për reputacionin e mirë të përfaqësuesit ligjor të subjektit transportues dhe drejtuesit/drejtuesve të veprimtarisë, lidhjet 7/1 dhe 7/2.

b) Dokumenti nga një institucion bankar ose financiar, që vërteton gjendje të qëndrueshme financiare, i cili mund të jetë:

i) një dokument/garanci bankare;

ii) një dokument i lëshuar nga shoqëri sigurimi.

Këto dokumente duhet të parashikojnë një vlerë në përputhje me shumat e përcaktuara në pikën 1.2, të nenit 4, si dhe duhet të vërtetojnë se banka/shoqëria e sigurimit janë garant, për subjektin që kërkon të licencohet.

Gjithashtu, do të pranohen dokumente të lëshuara nga çdo bankë, institucion financiar ose institucione të ngarkuara për këtë qëllim në çdo shtet anëtar të BE-së, ku individit ose subjektit i transportit rrugor apo filiali i tij është regjistruar.

c) Certifikata e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë, i cili mund të jetë ortaku i vetëm ose një prej ortakëve, apo administratori i subjektit ose një person i punësuar me kontratë për një periudhë të paktën 5 vjeçare;

d) Regjistrimi në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku objekti i veprimtarisë duhet të jetë “Për transport udhëtarësh brenda vendit”.

e) Licenca origjinale e lëshuar nga bashkia, dhe në rast se dokumenti origjinal ka humbur, apo është dëmtuar, kopja e njehsuar me origjinalin.

2. Për mjetet, numrin e nevojshëm të kërkuar për shërbimin që do të operohet dhe për secilin mjet dokumentet si më poshtë:

a) Leja e qarkullimit;

b) Certifikata e kontrollit teknik të mjeteve;

c) Aktvlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit të mjeteve në transportin e udhëtarëve brenda vendit, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), sipas udhëzimit nr.1649 datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar;

d) Certifikata e kalibrimit të tahografit;

e) Regjistrimi i mjeteve në QKB.

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të njehsuara me origjinalin.

3. Për drejtuesin e mjetit dokumentet, si më poshtë:

a) Leja e drejtimit për drejtuesin e mjetit, me kategoritë përkatëse për mjetin që drejton;

b) Certifikata e aftësisë profesionale (CAP) për drejtuesit e mjeteve në përputhje me udhëzimin nr. 3606/2, datë 28.10.2011, “Për pajisjen e përdoruesve të mjeteve rrugore të kategorive C, CE, D (\*) dhe DE, me certifikatën e aftësisë profesionale (ÇAP)”, të ndryshuar, kur kërkohet.

4. Në rastin e shërbimeve të rregullta sipas pikës 1, të nenit 4, të ketë agjenci për shërbimin e udhëtarëve brenda vendit, ose kontratë me një agjenci transporti.

5. Policë sigurimi se pronari/përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar, i cili në transportin e udhëtarëve përfshin:

a) Sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik;


b) Sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti.

6. Subjektet që aplikojnë për licencë, duhet të sigurojnë çdo informacion të mëtejshëm, të cilin ata e konsiderojnë të rëndësishëm ose që kërkohet nga autoriteti licencues, në mënyrë të veçantë një program drejtimi të mjetit, për monitorimin në pajtueshmërinë me legjislacionin mbi orët e drejtimit dhe periudhat e pushimit të drejtuesve.

## KOMISIONI I VLERËSIMIT


**KRYETAR**

Vangjel **NUSHI**



**ANËTAR**

Shkëlqim **BEQIRAJ**



**ANËTAR**

Arben **SHPËRDHEJA**

